



ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **UNIVERSITETI " HAXHI ZEKA " NË PEJË**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP:

Nr i Prokurimit	uhz-20-2062-5-1-1
Nr i brendshëm	208 20 013 151

Sa i përket tenderit për „ Ndërtimi i Fakultetit të Arteve (Faza e Katërt) ”

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Construmax SH.P.K

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr. Mentor Krasniqi p.n. Bukosh Suharekë

(Adresa)

Suharekë

(Vendi)

049137004

(Numri Telefonit)

23000

(Kodi postar)

(Numri i Faks-it)

Faton Krasniqi

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

info@construmax.eu

(Adresa elektronike)



28.07.2020

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtrojë ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs të projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për Kontratë'' në VVebfaqen e-prokurimi <https://e-prokurimi.rks-gov.net/> me datë 19.05.2020, ndërsa

Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues në email me datë 12.06.2020

Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues në email me datë 15.07.2020

Afati i fundit për dorzim tenderi 02.06.2020, procesi për Hapjen e Tenderëve në ora 13:00.

III.2) KUSHTET PËR PJESËMARRJE

III.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë:	<i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i>
Kërkesa 1 Deklaratë nën betim - Operatori ekonomik duhet ti përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë në pajtim me Ligjin Nr. 04 L-042, Neni 65 duke përdorur formën në Aneksin 2.	Dëshmi 1 Deklaratë nën betim -duhet të dorëzohet në origjinal, e nënshkruar dhe i vulosur nga O. Ekonomik.
2) Dëshmi se Operatori Ekonomik nuk është në falimentim ose nën administrim të dhunshëm gjyqësorë të lëshuar nga Gjykata kompetente e vendit të themelimit të Operatorit Ekonomik.	2) Një vërtetim i lëshuar nga Gjykata kompetente Vërtetimi kërkohet vetëm nga Operatori Ekonomik që propozohet për dhënie të kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit të njoftimit për dhënie të kontratës dhe nuk duhet të jete me i vjetër se 180 ditë nga data e lëshimit deri ne datën e hapjes së ofertave. Vërejtje Në rastet kur dokumenti në fjalë nuk mund të nxjerrët për arsye Objektive, Duke u bazuar në Njoftimin e datës 30.03.2020 të nxjerrë nga KRPP, Operatori i rekomanduar për dhënie të kontratës mund ta dërgoj në AK, një DEKLARATË ME SHKRIM NËN BETIM , përmes sistemit të e- prokurimit.
3) Një vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është delikuent (shkelës) në pagesën e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit.	Vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik. Vlefshmëria e vërtetimit duhet të jete maksimumi 90 dite nga data e lëshimit deri ne datën e hapjes se ofertave. Vërtetimi kërkohet, vetëm nga Operatori Ekonomik që rekomandohet për dhënie të kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit të Njoftimit për Dhënie të Kontratës. Vërejtje Në rastet kur dokumenti në fjalë nuk mund të nxjerrët për arsye Objektive, Duke u bazuar në Njoftimin e datës 30.03.2020 të nxjerrë nga KRPP, Operatori i rekomanduar për dhënie të kontratës mund ta dërgoj në AK, një DEKLARATË ME SHKRIM NËN BETIM , përmes sistemit të e- prokurimit.
III.2.2) Përshtatshmëria profesionale:	<i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i>
1. Regjistrimi i operatorit ekonomik në regjistrin përkatës profesional, të bizneseve dhe ose të korporatave.	1. Kopja e Certifikatës së biznesit së bashku me pjesët informative të biznesit.
2. Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të jenë deklurues të TVSH-së	2. Kopja e certifikatës së TVSH-së të lëshuar nga Organi Kompetent
3. Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë regjistruar numrin fiskal në ATK	3. Kopja e Certifikatës së regjistrimit të numrit fiskal (nëse nuk është e përfshirë në certifikatën e biznesit).
4. Certifikata për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë EN – ISO 9001 2015	Dëshmia 4. Kopje e certifikatës EN –ISO 9001 2015 valide
5. Certifikata për menaxhimin e shëndetit në	Dëshmia 5. Kopje e certifikatës EN –ISO 45001

punë EN – ISO 45001 2018	2018 valide
6. Certifikata për Vlerësimin e zhurmës mjedisore si dhe përcaktimi i volumit në Objekt (Pasiqe është Objekt Universitar- F. Arteve) ISO 1996-2 2017	Dëshmia 6. Kopje e certifikatës EN –ISO 1996-2 2017 valide
7. Certifikata për shkrirjen e metaleve dhe bashkimin e tyre (Pasiqe do të instalohet i gjithë sistemi i ngrohjes qendrore dhe behet saldimi i gypave) ISO 3834-2 2005	Dëshmia 7. Kopje e certifikatës EN –ISO ISO 3834-2 2005 valide
III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar: 1. Operatori ekonomik duhet ti ofrojë dëshmi të kënaqshme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi vjetor i Operatorit Ekonomik, gjate tre viteve të fundit nga data e publikimit të njoftimit për kontratë, minimumi 2,400,000.00 €. Në rast konsorciumi lideri duhet të ketë të paktën 60% të vlerës së qarkullimit.	<i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i> Dëshmia 1. Pasqyrat financiare të kompanisë, të shoqëruar me qarkullimin financiar nga banka për tri vitet e fundit apo deklaratat e tatimeve vjetore të dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës.
III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional: 1. Projektet të ngjashme të ndërtimit të realizuara në tri vitet e fundit (Nga data e publikimit të njoftimit) e vërtetuar nga OE, ku përfshihen titujt e projekteve, numri, data e kontraktimit dhe vlera, minimumi të jetë 1,800,000.00 €. Në rast të grupit Udhëheqësi duhet ti ketë së paku 60% të shumës së kërkuar punë të ngjashme të realizuara në 3 vitet e fundit. 2. Të paraqitet stafi që do të angazhohet në këtë projekt, të cilët drejtpërdrejtë janë përgjegjës në ekzekutimin e punëve dhe në përgjithësi të projektit duke përfshirë edhe stafin profesional. - Stafi teknik (PUNONJËS) që do të kyçet në projekt -minimumi 30 punonjës, ku të paktën 15 prej tyre duhet të jenë të trajnuar certifikuar nga ndonjë kompani e licencuar në Kosovë për ushtrimin e punëve profesionale nga siguria dhe shëndeti në Punë, sipas nenit 5, paragrafi 1.3 i rregullores nr. 02 2014.	<i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i> 1. Lista e projekteve të ngjashme e vërtetuar për tri vitet e fundit nga OE- (e skanuar nga origjinali) të dëshmuara me referenca dhe proces verbal të pranimit teknik –(kopje). Projektet e realizuara në sektorin privat të dëshmohen me vërtetim nga banka (ku evidentohen pagesat në bankë). 2. Lista e punëtorëve me para kontrata minimum 30 punëtorë ose me Liste të ATK-së, si dhe certifikata e kërkuar kopje për secilin punëtor (minimum 15).
3. Stafi i lartë profesional që do të kyçet në projekt minimum 6 inxhinierë dhe 1 CCNA i certifikuar Një (1) Menaxheri i Projektit të jetë Inxhinier i Diplomuar i Ndërtimtarisë ose Master i drejtimit konstruktiv me përvojë pune minimum 5 vjeçare pas diplomimit, i cili duhet të ketë të paktën dy projekte të mbikëqyrura, vlera e projekteve (Secili) mbi 350,000.00€ Një (1) Inxhinier i Diplomuar i Arkitekturës ose Master i Arkitekturës, me përvojë pune minimum 5 vjeçare pas diplomimit, i certifikuar sipas standarteve EN 16247 dhe i certifikuar me certifikaten iSBEMxK. Një (1) Inxhinier i Diplomuar i Elektroteknikës ose me diplome Master, min. pese vite përvojë pune pas	3. Dëshmitë për stafin profesional Kontrata e punës ose parakontrata në emër të projektit. Kopja e diplomave Universitare (Certifikatave), ose origjinal. CV-ja duhet të dorëzohet në kopje mirëpo e nënshkruar nga inxhinieri 5 (pesë) vite përvojë pune pas diplomimit. Tekniku CCNA- Kopja e certifikatës dhe Kontrata Ose parakontrata. Vendimi për caktimin e Menaxherit të projektit, i cili duhet të ketë të paktën dy projekte të mbikëqyrura, vlera e projekteve mbi 350,000.00€

<p>diplomimit. Një (1) Inxhinier i Diplomuar i Ndertimitarise drejtimi Hidroteknik ose me diplome Master ne kete drejtim, me min. pese vite përvojë pune pas diplomimit. Një(1) Inxhinier i Diplomuar i Makinerisë ose me diplome Master në këtë drejtim me min. pese vite përvojë pune pas diplomimit. Një (1)- Inxhinier i Diplomuar i Arteve ne dizajni ose me diplome Master në këtë drejtim, min. pesë vite përvojë pune pas diplomimit. Një (1) Arkitekt Dizajni Urban të jetë i pajisur me certifikatë FIDIC Një (1)- Teknik i certifikuar drejtimi CCNA.</p>	
<p>4. Lista e mjeteve te punës në dispozicion për realizimin e punimeve 1.Kamion Kiper (VETË SHKARKUES) minimum 2 copë; 2.Auto Mikser minimum 3 copë; 3.Vinq Stattik minimum 1copë; 4.Auto Pomp minimum 1copë; 5. Ekskavator mbi(5-8ton) minimum 1copë 6. Skele për llyrje të Objekteve (jashtë) minimum 1000 m2</p>	<p>4. Lista e pajisjeve – mjeteve të punës që OE duhet ti ketë të vetat apo të kontraktuara (apo me qira), të dëshmohen me kopje të librezave, deklarata doganore apo ndonjë dëshmi tjetër. Të dëshmohet se pajisjet mtorike janë të regjistruara dhe kanë sigurim valid- Kopju e librezave të paisjeve.</p>

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☒

Jo ☐

Tenderin e kemi dorzuar në mënyr elektronike. Hapja e ofertës është bërë në kohë të caktuar dhe oferta e jone ka qene me qmim më e shtrejtja nën vlerën e parashikuar të kontrates.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒

Jo ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Kompania jonë më datë 12.06.2020 ka pranuar në e-prokurim nga AK-UNIVERSITETI " HAXHI ZEKA " NË PEJË „Letrën standarde për tenderuesin e pasuksesshëm" dhe „Njoftimin mbi vendimin e AK" që kanë shpallur fitues kompaninë që supozojmë është e papërgjegjshme. Ne kemi bërë kërkesë për çasjen në dokumentacionin e OE të shpallur si fitues nga AK dhe pastaj kemi dorëzuar në e-prokurimi "Kërkesën për Rishqyrtim" më datën 15.06.2020, ku AK ka kthyer lënden në rivelrsim duke konsideruar si të bazuar kërkesën për rishqyrtim dhe me datë 15.07.2020 përsëri na ka dërguar „Njoftimin mbi vendimin e AK" dhe „Letrën standarde për tenderuesin e pasuksesshëm" duke shpallë të njejtin . Ne menjëher kemi kërkuar qasje në dokumentacionin e OE nëse janë sqaruar, ku nuk na u mundësua nga AK, dhe me datë 18.07.2020 kemi bërë përsëri Kërkesë për Rishqyrtim, dhe kemi marrë "Vendimi lidhur mbi Refuzimin e kërkesës për rishqyrtim" më datë 21.07.2020 ku janë dhënë arsye të pabazuara dhe që janë në kundërshtim me LPP-në dhe me kriteret e vendosura nga vetë AK-ja!

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

1. Neni 1 i LPP-së - Qëllimi
2. Neni 7 i LPP-së - Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi;
3. Neni 10 i LPP-së- Mjetet për promovimin e Transparencës
4. Neni 66 i LPP-së- Përshtatshmëria Profesionale
5. Neni 56 i LPP-së- Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave
6. Neni 59 i LPP-së- Ekzaminimi, vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve
7. Neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës
8. Neni 61 i LPP-së- Tenderët Jo-Normalisht të Ulët
9. Neni 66 i LPP-së- Përshtatshmëria Profesionale
10. Neni 69 i LPP-së- Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale
11. Neni 72 i LPP-së- Dokumentacioni dhe informacioni shtesë
12. Neni 108/A i LPP-së- Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

13. RruOPP

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Si palë e pakënaqur me „Njoftimin mbi Vendimin e dytë të Autoritetit Kontraktues” të datës 15.07.2020 ku oferta e jonë ka qenë e vetmja e përgjegjshme për aktivitetin e prokurimit „Ndërtimi i Fakultetit të Arteve (Faza e Katërt)” uhz-20-2062-511, pasi kemi dorëzuar ofertë të përgjegjshme nën vlerën e parashikuar të kontratës dhe nga vendimi i vetë AK vërejmë që vetëm fituesi është vlerësuar i përgjegjshëm dhe mungojnë Letrat standarde të OE tjerë, konsiderojmë se Autoriteti Kontraktues ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të LPP-së Nr. 04/L-042, siç janë:

Së pari ju informojmë se Autoriteti kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit nuk ka respektuar nenin 59 të LPP-së sepse ka rekomanduar për kontratë OE Rexha SH.P.K”, i cili operator ekonomik është i papërgjegjshëm duke mos plotësuar dokumentet e kërkuara si në vijim.

- Në FDT te pika 9.1&9.2 është kërkuar „Projektet të ngjashme të ndërtimit të realizuara në tri vitet e fundit (Nga data e publikimit të njoftimit) e vërtetuar nga OE, ku përfshihen titujt e projekteve, numri, data e kontraktimit dhe vlera, minimumi të jetë 1,800.000.00 €” - kurse OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar dëshmi disa referenca për projekte që janë me të vjetra se 3 vite, prandaj këto dëshmi nuk janë në përputhshmëri me kërkesat e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë dhe në mungesë të këtyre dëshmive ky OE është dashur të eliminohet si i papërgjegjshëm.
- Nuk e ka dorëzuar paramasën e nënshkruar dhe të vulosur në e-prokurim
- Nuk ka plotësuar kërkesën e dosjes së tenderit pika 9.1&9.2 e FDT, ku si dëshmi në lidhje me pajisjet, është kërkuara „Lista e pajisjeve – mjeteve të punës që OE duhet ti ketë të vetat apo të kontraktuara (apo me qira), të dëshmohen me kopje të librezave, deklaratë doganore apo ndonjë dëshmi tjetër.”, ndërsa OE i rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar dëshmi se ka në pronësi apo marrëveshje për shfrytëzim 1000m² skele
- Diploma e inxhinierit të makinerisë është një kopje e diplomës të lëshuar në Shqipëri e cila nuk ka dëshmi të nostrifikimit, prandaj edhe për këtë arsye i njëjti OE duhet të shpallet i papërgjegjshëm sepse nuk mund të punohet dhe pranohet në Kosovë një diplomë e cila nuk është e nostrifikuara.
- Në dosje të tenderit te FDT te pika 9.1&9.2 në lidhje me Dëshmitë për stafin profesional është kërkuar „ CV-ja- duhet të dorëzohet në kopje mirëpo e nënshkruar nga inxhinieri 5 (pesë) vite përvojë pune pas diplomimit, kurse CV e inxhinierit të

makinerisë është e pa nënshkruar nga vetë inxhinieri prandaj ky OE duhet të shpallet i papërgjegjshëm.

- CV e inxhinierit të elektrikes nuk i përmban të dhënat e mjaftueshme sipas kërkesës për Njoftim për Kontrat, prandaj sipas nenit 39 të RrUOPP kur CV nuk përmbush kërkesat duhet refuzuar tenderin pa kërkuar sqarime.
- Certifikata prezentuar pas kërkesës për sqarim EN 16247 për inxhinierin e arkitekturës, nuk është certifikatë valide e cila certifikatë është kërkuar në Njoftim Për Kontratë dhe nuk mund të gjendet në Vebfaqen e ati certifikuesi.
- Për certifikatën ISO 45001:2018, me Nr.AQS -S-46262019, kemi shikuar në veb faqe të AQS, dhe askund nuk shkruan se është i certifikuar me këtë ISO.
- Në CV të inxhinierëve ceket që kanë filluar punën tek Rexha që nga vitet 2014 apo 2015 dhe vazhdojnë ndërsa ka prezentu kontrata bashkëpunimi vetëm për këtë projekt që bie në kundërshtim me vetveten. Pra këto dëshmi janë kundërthënëse dhe nuk mund të merren parasysh dhe nuk mund të merren si valide.
- Pozicionet elektrike janë tepër të ulta jashtë çmimit të tregut ku mund të vërtetohen në Internet në prodhuesit që kanë këto specifika që janë kërkuar pozicionet nga E1.2.26-E1.2.34. Prandaj me këto çmime kuptohet se ky OE ka ofruar çmime jo normalisht të ulëta dhe duhet të eliminohet sipas nenit 61 të LPP.

OE Alfa I sh.p.k. :

- Polisa e Sigurimit te tenderit është lëshuar për 119 ditë nga data 02.06.2020 deri më 29.09.2020 ndërsa kërkesë në dosje të tenderit dhe në Njoftim për kontratë ka qenë 120 ditë, prandaj është i papërgjegjshëm ky operator ekonomik
- Në paramasen e dorëzuar të nënshkruar dhe vulosur të pozicionet e makinerisë ky OE ka ndryshuar sasinë e paramases së publikuar nga AK në pozicionin M4.9 nga 0.3% ka vendosur 0.25% që është në kundërshtim me LPP-në, pandaj AK u deshtë të eliminoj automatikisht.
- CV e inxhinierit të arkitekturës supozojmë që nuk është e nënshkruar nga vetë Nafije Gashi pasi që dallon nënshkrimi në kontratë dhe në CV, prandaj duhet të vërtetohet.
- CV e inxhinierit të makinerisë Safet Maxharraj supozojmë që nuk është e nënshkruar nga vetë inxhinieri pasi që dallon nënshkrimi në kontratë dhe në CV, prandaj duhet të vërtetohet.
- Te dosja e tenderit-pika 9.1&9.2 si dëshmi dokumentare është kërkuar „Lista e pajisjeve – mjeteve të punës që OE duhet ti ketë të vetat apo të kontraktuara (apo me qira), të dëshmohen me kopje të librezave, deklaratë doganore apo ndonjë dëshmi tjetër, kurse OE Alfa I disa makineri si Autobetonjerka mikser 01-594-LM, Autobetonjerka mikser 01-595-LH , Autobetonjerka 01-596-LH nuk janë në emër të ALFA I-së e as në emër të partnerit që ka bërë marrëveshje mirpo të një pronari tjetër që nuk ka dëshmi që ka marrëveshje për dhënie me qira në mes ALFA I-së dhe atij për këtë projekt.
- Nuk i ka plotësuar të gjitha pozicionet që kanë qenë në paramas mirëpo janë plotësuar vetëm pozicionet që kanë pasur sasi

- Pozicionet elektrike janë tepër të ulta jashtë çmimit të tregut ku mund të vërtetohen në Internet në prodhuesit që kanë këto specifika që janë kërkuar pozicionet nga E1.2.26-E1.2.34. Prandaj me këto çmime kuptohet se ky OE ka ofruar çmime jo normalisht të ulëta dhe duhet të eliminohet sipas nenit 61 të LPP.
- Mungon dudi për Vinc static e cila është arsye eliminuese e këtij OE edhe në vendimin e AK, kurse kërkesë e dosjes së tenderit pika 9.1&9.2 e FDT, si dëshmi në lidhje me pajisjet, është kërkuar „Lista e pajisjeve – mjeteve të punës që OE duhet ti ketë të vetat apo të kontraktuara (apo me qira), të dëshmohen me kopje të librezave, deklarata doganore apo ndonjë dëshmi tjetër
- Menaxheri i projektit nuk ka dy referenca për mbikëqyrjen e projekteve mbi 350,000.00, sipas kërkesave në dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë.

DAJTING

- Në dosje të tenderit te FDT te pika 9.1&9.2 është kërkuar „Projektet të ngjashme të ndërtimit të realizuara në tri vitet e fundit (Nga data e publikimit të njoftimit) e vërtetuar nga OE, ku përfshihen titujt e projekteve, numri, data e kontraktimit dhe vlera, minimumi të jetë 1,800.000.00 €” – kurse ky operator ekonomik ka prezentuar vetëm një referencë të ndërtimit të një shkolle në vlerë të vogël ndërsa referencat tjera janë referenca të auditimit energjetik dhe dhe masa efçente në objekte, dhe referenca të natyrave tjera, prandaj është i papërgjegjshëm.
- Në dosje të tenderit te FDT te pika 9.1&9.2 është kërkuar „ Një (1)Menaxheri i Projektit të jete Inxhinier i Diplomuar i Ndërtimtarisë ose Master i drejtimit konstruktiv me përvojë pune minimum 5 vjeçare pas diplomimit, i cili duhet të ketë të paktën dy projekte të mbikëqyrura, vlera e projekteve (Secili) mbi 350,000.00€, kurse Menaxheri i prezantuar nga ky OE nuk ka ofru dëshmi që ka përvojën që ka menaxhuar së paku dy kontrata në vlerë jo ma të vogël se 350 000 euro por ka prezentu vetëm një referencë të ndërtimit, prandaj është i papërgjegjshëm
- Nuk i ka plotsuar të gjitha pozicionet që kanë qenë në paramas mirpo janë plotsuar vetëm pozicionet që kanë pasur sasi, prandaj është i papërgjegjshëm.
- Nuk i ka 15 punëtor të trajnuar në mbrojtje në punë në emër të dy partnerëve të konzorciumit që janë punëtor të kompanive të konzorciumit të trajnuar mirëpo janë prezentuar punëtor të kompanive tjera që nuk kanë asnjë marrëveshje mes kompanive të konzorciumit, në kundërshtim me nenin 5,paragrafi 1.3 i rregullores nr. 02 2014.
- Pozicionet elektrike janë tepër të ulta jashtë çmimit të tregut ku mund të vërtetohen në Internet në prodhuesit që kanë këto specifika që janë kërkuar pozicionet nga E1.2.26-E1.2.34. Prandaj me këto çmime kuptohet se ky OE ka ofruar çmime jo normalisht të ulëta dhe duhet të eliminohet sipas nenit 61 të LPP.

- Marrëveshjet për shfrytëzimin e mjeteve nuk janë komform ligjit për marrëdhëniet e Detyrimeve Nr. 04/L-077, prandaj nuk ofrojnë siguri të AK se paisjet mund të shfrytëzohen për kryerjen e punëve në këtë aktivitet të prokurimit. (kjo kontratë si shitës ka të cekur vetëm emrin e ndërmarrjes e cila nuk specifikohet a është "SHPK" apo BI, po ashtu marrëveshja është e lidhur në mes shitësit dhe blerësit ndërsa në tekstin e kontratës del të jetë shfrytëzim me QERA që kontrata bie së pari ndesh në vetvete, po ashtu makineria e cila është "huazuar" apo "Blerë" figuron në emër të dy ndërmarrjeve të ndryshme e ku njëra nga tonë ARBK figuron e mbyllur), prandaj ky operator ekonomik është i papërgjegjshëm.
- Stafit I njëjti nuk I plotëson kërkesat sipas dosjes së tenderit pasi që nuk I ka 30 staf teknik në listën e stafit teknik janë vetëm 25 staf, të tjerët janë administrat dhe staf profesional

Ndërsa tek OE NNPStandard shpk dhe Arifaj shpk, si dhe te OE EKO Group qëndrojnë gjetjet e AK ku këta dy ofertues është konstatuar se nuk i plotësojnë përshtatshmëritë profesionale dhe kapacitetet teknike dhe profesionale e as administrative.

Neve në herën e parë eliminuar për mungesë të ofrimit të planit dinamik, mirëpo ne ju sqarojmë se tek njoftimi për kontratë nuk është kërkuar fare plani dinamik dhe plani dinamik nuk është ndonjë kërkesë kualifikuese e cila mund të ndikon në përgjegjshmërinë administratave sepse plani dinamik mund të përcaktohet edhe para nënshkrimit të kontratës.

Po ashtu bazuar në përgjigjëjen e KRPP tek pyetjet e shpeshta të dates 14.07.2017 citoj:

„ Paragrafi 4 i nenit 27 të këtij si dhe paragrafi 4 i nenit 18 të Rregullave dhe UOPP, përcaktojnë:

“...Kërkesat e përcaktuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë duhet të jenë identike”.

Në përputhje me nenin 27.4 të këtij ligji dhe nenin 18.4 të Rregullave dhe UOPP autoriteti kontraktues obligohet që gjatë procesit të përgatitjes së Dosjes së Tenderit dhe Njoftimit për Kontratë, t'i kontrollojë për t'u siguruar se dokumentet në fjalë përmbajnë informata identike dhe t'i publikoj ato në system për t'i bërë të qasëshme për të gjithë operatorët ekonomik të interesuar.

Si rregull, AK duhet të sigurohet që të gjitha versionet gjuhësore të DT dhe NJK të përmbajnë informata identike sidomos në lidhje me kriteret e përzgjedhjes, kushtet dhe afatet e specifikuar në Dosjen e tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë.

Sipas nenit 59 të këtij ligji, Vlerësimi, ekzaminimi dhe krahasimi i tenderëve është kompetencë dhe përgjegjësi e plotë e autoritetit kontraktues.

Paragrafi 4 i nenit 59 të këtij ligji përcakton:

“Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit në fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundur, dhe të merrret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve”.

Si rrjedhojë, ndërhyrja e AK-së në Dosjen e Tenderit me qëllim të ndryshimit të ndonjë kërkesë të specifikuar në Dosjen e Tenderit dhe pa e ndryshuar të njëjtën edhe në Njoftimin për Kontratë konsiderohet veprim i neglizhuar i AK-së dhe për veprime neglizhente të AK-së nuk mund të dëmtohen OE-të pjesëmarrëse në aktivitetet e prokurimit”

Me këtë vlerësim autoriteti kontraktues ka vepru edhe në kundërshtim me nenin 56 të LPP sepse, duke na eliminu për një kërkesë që nuk ka qenë tek njoftimi për kontratë, ndërsa edhe po të ishte atëherë mund të konsiderohet devijim i vogël sipas nenit 59 paragrafi 4 pika (ii), sepse nuk ndikon në përmbajtje dhe nuk shkakton ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

- Neni 59 i LPP-së- Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve

Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë sipas këtij neni, sepse AK ka shpall fitues operatorin ekonomik i cili nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë, ndërsa neve na ka eliminuar për një kërkesë e cila nuk ka qenë e përcaktuar te njoftimi për kontratë në kundërshtim me nenin 56.3 të LPP, ndërsa edhe po të ishte kërkuar edhe nëse nuk do të ofrohej në këtë fazë ka mundur të kërkohej sqarime shtesë sipas nenit 59.2 të LPP-së sepse aty parashihet që të mund të kërkohej një sqarim me shkrim mbi cilin do aspekt të tenderit.

- Neni 72 i LPP-së- Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

AK ka bërë shkelje esenciale të këtij neni pasi që ka kërkuar sqarime te OE që është shpall fitues, edhe pse nuk i ka plotësuar kushtet administrative dhe do të duhej refuzuar menjëherë oferta e tij. AK-ja e ka përdor nenin 72 në mënyrë favorizuese për operatorin fitues ndërsa në mënyrë diskriminuese për neve sepse ka kërkuar sqarime shtesë për fituesin edhe pse është i papërgjegjshëm, ndërsa kompania jonë është eliminuar për një kërkesë që nuk ka qenë në Njoftim për Kontratë, pra për plani dinamik, dhe bazuar në nenin 72 dhe RuUOPP kanë mundur të kërkojnë sqarim shtesë, apo ka mund të kërkohej para nënshkrimit të kontratës bazuar në LPP-në dhe planin e menaxhimit.

- Neni 108/A i LPP-së- Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

Konsiderojmë që AK edhe pse ka bërë kthimin e lëndës në rivlersim pas kërkesës tonë për rishqyrtim, nuk ka vepruar konform këtij neni, pasi që vendimi për shpalljen fitues ka qenë i njëjti mirpo vetëm kan munguar Letrat standarte për tenderuesit tjerë, dhe nuk kemi marrë përgjigjeje se cilat pretendime tona kanë qenë të bazuara e cilat jo.

• Neni 1 i LPP-së - Qëllimi

Konsiderojmë se Autoriteti Kontraktues ka bërë shkelje të dispozitave të nenit 1 të LPP-së për shkak që nuk ka siguruar mënyrën më efikase, të mjeteve duke shpallë një OE fitues i cili nuk i plotëson kriteret që kanë qenë të kërkuara për kontratë e as kushtet administrative, një OE që as paramasën nuk e ka dorëzuar të nënshkruar dhe vulosur dhe nuk ka prezentuar referenca të natyrës së ngjashme sipas kriterëve, dhe me qmime jo normalisht të ulëta . Prandaj me këtë vlerësim të AK nuk përmbushet qëllimi i LPP dhe nuk sigurohet mënyra më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë. Pra duke u shpall fitues OE i papërgjegjshëm nuk përmbushet parimi kryesor i LPP që të sigurohet mënyra më efikase dhe transparente të shfrytëzimit të mjeteve.

• Neni 7 i LPP-së - Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi;

Konsiderojmë se Autoriteti Kontraktues ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të nenit 7 të LPP-së për shkak të shpalljes fitues të një OE të papërgjegjshëm, duke e favorizuar këtë operator, ndërsa, Ndërsa neve si OE që kemi qenë të vetmit të përgjegjshëm dhe kemi qenë me një çmim të arsyeshëm për këtë kontratë i cili është nën vlerën e parashikuar të projektit na kanë eliminuar për mos dorëzim të planit dinamik, ku kjo kërkesë nuk ka qenë në kriteret e përcaktuara nga vetë AK në Njoftim për Kontratë, mirëpo janë thirrur në dosje të tenderit mirëpo ne nuk duhet të pësojmë për shkak të ndonjë lëshimi eventual të autoritetit kontraktues, sepse bazuar në LPP-në dhe planin e menaxhimi të kontratës Plani dinamik dorëzohet para nënshkrimit të kontratës, mirëpo ka mundur edhe të kërkohej sqarime sipas nenit 59.2 dhe 72 të LPP, mirëpo neve nuk na janë kërkuar sqarime duke na diskriminuar në këtë aktivitet të prokurimit.

Në paragrafin 6 pik (vi) të këtij neni shkruan që AK duhet të sigurohet „që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtësore të kushteve, kriterëve dhe specifikimeve përkatëse,„. Ndërsa në këtë rast oferta e OE të shpallur fitues nuk përputhet me të gjitha aspektet përmbajtësore.

• Neni 10 i LPP-së- Mjetet për promovimin e Transparencës

Konsiderojmë se Autoriteti Kontraktues ka bërë shkelje esenciale të këtij neni, duke mos promovuar transparencë pas marrjes së vendimit të II-të, pasi që ne si kompani kemi kërkuar qasje në dokumentacion në e-prokurim dhe email zyrtar të AK, për të na lejuar qasje apo të na dërguar sqarime për OE nëse janë bërë, dhe nuk kemi marrë asnjë përgjigje e as lejim në qasje të dokumentacionit.

Autoriteti kontraktues e ka shkelur këtë dispozitë ligjore duke mos na lejuar qasje pas marrjes së vendimit të dytë dhe publikimit të njoftimit mbi vendimin me formularin B58.

Duke pasur parasysh që në herën e parë na ishte aprovuar kërkesa për rishqyrtim e ku ishte shpallur fitues i njëjti operator ekonomik që është shpallur edhe tani, ka qenë me interes të dijmë se çka ka ndikuar që një herë të na aprovohet kërkesa për rishqyrtim dhe përsëri të shpallet fitues i njëjti operator ekonomik. Pra ne kemi shprehur interesim se a janë ofruar ndonjë dëshmi shtesë nga OE i rekomanduar për kontratë dhe kemi qenë të interesuar të dimë se a janë të gjithë të papërgjegjshëm apo ka edhe të përgjegjshëm në këtë aktivitet të prokurimit. Andaj në

mungesë të informatave dhe dëshmime tjera jemi të detyruar të bëjmë kërkesë për rishqyrtim duke u bazuar vetëm nga qasja pas vendimit të I-rë dhe po ashtu po e parashtrijmë edhe ankesën pa pasur qasje në dokumentet dhe dëshmitë tjera në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit. Gjithashtu në Vendimin e II-të është cekur një person tjetër i autorizuar, dhe i mungojnë të dhënat kontaktuese (email, nr tel etj), dhe ne si kompani kemi tentuar 2 ditë me kontaktin në nr e telefonit zyrtarë dhe nuk kemi marrë përgjigje, e as në emailin zyrtar. Duke u bazuar në të gjitha këto që potenciam konsiderojmë AK edhe pse ka pasur transparencë mbas vendit të I-rë, në vendimin e II-të nuk kemi vërejtë transparencë e as komunikim nga ana e tyre.

• **Neni 59 i LPP-së- Ekzaminimi, vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve**

Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në përputhje me nenin 59 të LPP sepse AK e ka rekomanduar për kontratë OE i cili nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë, kurse neni 59 paragrafi 4 e cakton shumë mirë ku shkruan „ Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit,„. Prandaj OE Rexha SHPK nuk mund të konsiderohet i përgjegjshëm.

Prandaj pa dashur të lëshohem më tepër në këtë konsiderojmë që Autoriteti Kontraktues ka bërë shkelje esenciale të këtyre neneve duke shpallur fitues një OE të pa përgjegjshëm dhe duke na eliminuar neve në kundërshtim me LPP-në vetëm që mos të shpallemi fitues pasi që kemi qenë i vetmi OE i përgjegjshëm dhe brenda vlerës së parashikuar të kontratës. Po ashtu OE i shpallur fitues ka shumë çmime që janë jo normalisht të ulëta ku edhe vetë çmimi total i ofertuar tregon pasi që 340 mijë euro është më lirë se vlera e parashikuar dhe objekti është një objekt i rëndësisë së madhe.

Oferta jonë ka qenë oferta e përgjegjshme dhe ka qenë ofert brenda vlerës së parashikuar të kontratës dhe kemi ofruar të gjithë dokumentacionin e kompletuar sipas kërkesave dhe kritereve.

Prandaj ndihemi të dëmtuar me vendimin për shpalljen fitues të kompanis së papërgjegjshme për këtë aktivitet të prokurimit në kundërshtim me dispozitat e lartëcekura të LPP-së

Prandaj duke u bazuar në këtë shkresë dhe dokumentacionin e bashkangjitur, konsiderojmë se AK UNIVERSITETI " HAXHI ZEKA " NË PEJË ka bërë shkelje të dispozitave të lartëcekura të LPP-së, dhe kërkojmë nga OSHP që të na APROVOJË ankesën tonë si të bazuar dhe ta ANULOJË njoftimin mbi vendimin e AK (B58), kurse lëndën ta kthejë në RIVLERËISM.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Shpenzime për përgaditjen e ofertës teknike dhe në aspektin kohor dhe dëmtime në vlerën e kontratës 1,020,304.05€ që supozojmë se jemi të kompletuar me dokumentacionin e kërkuar sipas dosjes së tenderit nga Autoriteti Kontraktues.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,*
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*